



Bashkimi Evropian Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve

KUMTESË PËR SHTYP: BE MVZ/2013/10

Deklaratë Preliminare e Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Trendi pozitiv u konfirmua në raundin e dytë

Prishtinë, 3 dhjetor 2013 – Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave në Kosovë në shumicën e komunave ishte i qetë, duke konfirmuar trendin pozitiv të vërejtur në raundin e parë.

Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (BE MVZ) e vlerësoi me notë pozitive procesin e votimit në pothuajse të gjithë 330 vendvotimet e vëzhguara. Në përgjithësi, integriteti i votës është mbrojtur mjaftueshëm, por kishte edhe raportime të fotografimit të fletëvotimit dhe raste të votimit familjar. Numërimi është kryer shpejtë dhe pa parregullsi të mëdha.

“Jam i kënaqur që shoh se trendi pozitiv i vërejtur në zgjedhjet e 3 nëntorit është konfirmuar edhe në këtë raund të dytë të zgjedhjeve. Njerëzit patën mundësi të votojnë lirshëm dhe pa pengesa. Me këto zgjedhje, Kosova po shënon përparim të mëtejshëm në rrugën e saj demokratike. Shpresoj që këto zhvillime inkurajuese që i kemi vërejtur gjatë këtyre zgjedhjeve do të vazhdojnë deri në fund të procesit dhe se ato do të vënë themelet e forta të zhvillimit të ardhshëm demokratik të Kosovës. Suksesi i këtyre zgjedhjeve gjithashtu shënon një hap të rëndësishëm në zbatimin e Marrëveshjes së 19 prillit ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit”, tha Roberto Gualtieri, Shef i Misionit, me rastin e publikimit të Deklaratës Preliminare të Misionit.

Vëzhguesit e Be-së kanë qenë të pranishëm në tërë Kosovën për dy muaj. Deklarata e tyre preliminare mbulon zhvillimet që nga raundi i parë i zgjedhjeve.

Ambienti i përgjithshëm politik ishte i qetë, ndonëse kishte tensione dhe pretendime të presioneve ndaj votuesve dhe blerjes së votave në disa komuna. Të gjithë garuesit kanë mundur të bëjnë fushatë lirshëm dhe kanë gëzuar qasje në media për t'i përcjellë porositë e tyre tek elektorati. Ngjashëm me fushatën në raundin e parë, mbulimi i mediave pasqyrore aktivitetet e subjekteve politike, ku LDK ishte subjekti më i mbuluar në shumicën e mediave të monitoruara në gjuhën shqipe. Në raportimet e lajmeve politike në stacionet e monitoruara televizive në gjuhën serbe mbizotëronte G.I. ‘Srpska’.

Vëzhguesit e BE-së gjithashtu kanë identifikuar disa elemente të procesit të zgjedhjeve të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje më e madhe nga Kosova në të ardhmen.

Më shumë se gjysma e fletëvotimeve të dërguara përmes votimit jashtë Kosovës për zgjedhjet e 3 nëntorit janë shpallur të papranueshme nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shkak se nuk kishin kopje të një dokumenti të vlefshëm identifikues.

Procesi i numërimit të rezultateve të raundit të parë ishte i gjatë dhe kompleks dhe informatat në dispozicion në lidhje me saktësinë e materialeve zgjedhore dhe rezultateve të numëruara ishin të kufizuara. Në një masë kjo ka ulur transparencën e procesit.

Përderisa është realizuar në mënyrë të organizuar, procedimi i kontesteve zgjedhore nga ana e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) është kryer në mënyrë formaliste, pa inicim të hetimeve apo mbajtje të seanceve dëgjimore. Shumica e tyre janë hedhur poshtë. Megjithatë, vëzhguesit kanë theksuar se afatet për dorëzimin e ankesave dhe për marrje të vendimeve nga ana e PZAP-së janë të shkurtra, gjë që e bën këtë proces sfidues.

Rekomandimet për trajtimin e këtyre mangësive do të përfshihen në raportin përfundimtar të misionit i cili do të publikohet në fillim të vitit të ardhshëm.

Pyetjet e mediave duhet të drejtohen tek

Florence Marchal, Zyrtare për Media dhe Komunikim me Publikun, BE MVZ, +386 49 73 77 08

florence.marchal@eueomkosovo2013.eu

Versioni elektronik i Deklaratës Preliminare është në dispozicion në faqen e internetit të misionit

www.eueom.eu/kosovo2013